500	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit	7. Numri i aktgjykimeve te shkalles se pare dhe te dyte dhe te dhenat lidhur me aktgjykimet (liruese/denuese etj)	K4 2017	KGJK.	Gjatë vitit 2017 gjykatat e shkallës së parë kanë shqyrtuar 1 lëndë të kësaj natyre në mënyrë tjetër, pra nuk ka denim; Gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar asnjë lëndë të kësaj natyre.	E plotësuar
501	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit	8. Numri i personave të arrestuar dhe grupeve kriminale në rastet e shpërlarjes së parave dhe financimit te terrorizmit	K4 2017	MPB.	Gjatë periudhës raportuese lidhur me veprën penale Shpërlarje e parasë dhe financim të terrorizmit nuk është arrestuar asnjë person.	E paplotësuar
502	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve	2. Sasia dhe lloji i drogave të konfiskuara.	K4 2017	MPB.	Gjatë kësaj periudhe raportuese janë konfiskuar : Heroinë 372.7g Marihuanë 442kg e 785g Kokainë 245.95 g	Pjeserisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					Bime kanabisi 862	
503	Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve	3. Numri i kallximeve penale	K4 2017	MPB.	Gjatë K3 dhe K4 janë ngritur 556 Kallëzime Penale në lidhje trafikimin me narkotikë	Pjesërisht e plotësuar
504	Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve	5. Numri i informatave të shkëmbyera me institucionet vendore dhe ndërkombëtare	K4 2017	MPB.	Kërkesa dhe njoftime të pranuar nga DHTN 2, ILECU 89, Raporte të inteligjencës të pranuar nga DIA 156 Kërkesa të dërguara tek DIA 5, Kufiri 21, ILECU 54, Raporte të inteligjencës të dërguara tek DIA 16, DHTN Prishtinë 2.	Pjesërisht e plotësuar
505	Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve	6. Numri i operacioneve ndërkombëtare	K4 2017	MPB.	Gjatë K3 dhe K4 janë zhvilluar 2 takime operacionale dhe 3 hetime të përbashkëta ndërkombëtare. Është zhvilluar një operacion me karakter ndërkombëtar prej 4-6 Tetor në kuadër të Projektit "Hetimet e përbashkëta në luftimin e trafikimit të narkotikëve dhe armëve të zjarrit". Operacioni është zhvilluar në të njëjtën kohë në 17 vende të botës. Projekti udhëhiqet nga Austria në partneritet me Republikën e Kosovës dhe Republikën Çeke. Në kuadër të projektit janë realizuar dy takime operacionale dhe një operacion prej 04 deri me 06 Tetor 2017. Operacioni ka rezultuar me: - Arrestimin e 4 personave - Konfiskimin e 13 kg e 679 g marihuanë - 2 armë zjarri - Disa pjesë të armës	Pjesërisht e plotësuar
506	Hetimi dhe ndjekja efikase kundër drogave të paligjshme dhe të prekursorëve të tyre	7. Numri i aktakuzave të ngritura, masave të diversitetit dhe masave edukative për veprat penale të drogave të paligjshme dhe të prekursorëve të tyre	K4 2017	KPK.	Në tremujorin e katërt të këtij viti të gjitha prokuroritë kanë zgjidhur gjithsej 200 kallëzime penale me gjithsej 273 persona për veprën penale të Drogës. Prej 273 personave kanë përfunduar me aktakuzë gjithsej 211 persona. Po ashtu,	E plotësuar. Në realizim e sipër

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet janë pranuar gjithsej 55 vendime të gjykatës -Aktvendime fajësuese.	
507	Hetimi dhe ndjekja efikase kundër drogave të paligjshme dhe të prekursorëve të tyre	9. Numri i trajnimeve dhe aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve të prokurorëve për veprat penale të drogave të paligjshme dhe të prekursorëve të tyre	K4 2017	KPK. Akademia e drejtësisë	Në Akademinë e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm për periudhën raportuese janë trajnuar 87 prokurorë.	E plotësuar
508	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve	10. Numri i aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë dhe të dhenat lidhur me aktgjykimet (lirues/denues etj)	K4 2017	KGJK.	Gjatë vitit 2017 gjykatat e shkallës së parë kanë shqyrtuar 242 lëndë prej tyre: 112 lëndë– dënim me burg, 47 lëndë– dënim me gjobë, 51 lëndë– dënim me kusht, 4 lëndë – Aktgjykim Lirues, 4 lëndë – Aktgjykim Refuzues, 24 lëndë – Mënyrë Tjetër. Gjatë vitit 2017 gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar 97 lëndë prej tyre, për: 4 lëndë- hudhet ankesa, 54 lëndë – vërtetohet, 14 lëndë- është abroguar, 23 lëndë- është ndryshuar, 2 lëndë - për arsye tjera.	E plotësuar. Ne realizim e sipër
509	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	1. Numri i kallximeve penale lidhur me krim të organizuar dhe korrupsion	K4 2017	MPB. PK	Për periudhën kohore K3 dhe K4 lidhur me korrupsion janë hapur 82 raste për vepra penale të Korrupsionit ku janë ngritur 81 kallëzime penale ndaj 130 personave, janë bërë dy (2) kallëzime penale lidhur me krim të organizuar.	Pjesërisht e plotësuar
510	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	3. Numri i informatave të shkëmbyera	K4 2017	MPB. PK	Për periudhën kohore K3 dhe K4 janë pranuar 27 informata për dyshimin e veprave penale të Korrupsionit nga AKK, Polici (të brendshme), ATK, Qytetarë, ARC, Ministri, Kryetarë të Komunës ndërsa nga DIA janë pranuar 17 Informata. Gjatë kësaj periudhe kohore në kuadër të luftimit të krimit të organizuar janë shkëmbyer gjithsej 28 informata.	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

511	Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	4. Numri i operacioneve vendore ndërkombëtare dhe hetimeve të përbashkëta	K4 2017	MPB. PK	Gjatë periudhës K3 dhe K4 nuk ka pasur asnjë operacion vendor apo ndërkombëtar për fushën e luftimit të korrupsionit. Në fushën e krimit të organizuar nuk ka pasur asnjë operacion ndërkombëtar, por janë organizuar 14 operacione vendore.	Pjesërisht e plotësuar
512	Hetimi dhe ndjekja efikase kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda me shtrirje ndërkufitare	5. Numri i aktakuzave të ngritura për veprat penale të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda me shtrirje ndërkufitare	K4 2017	KPK. KGJK	Prokuroritë, gjatë tremujorit të katërt të këtij viti për veprat penale: krim i organizuar nuk kanë ngritur asnjë Aktakuzë.	E paplotësuar
513	Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit	8. 10% i Planit Strategjik për luftimin e korrupsionit i zbatuar	K4 2017	KPK.	Prokuroritë gjatë Tremujorit të katërt 2017, kanë pranuar në punë gjithsej 154 kallëzime me 223 persona të dyshuar për veprat penale që kanë të bëjnë me Korrupsionin. Rastet e pranuar sipas prokurorive të kësaj natyre janë si në vijim: Prokuroria Speciale gjatë këtij tremujori ka pranuar 1 kallëzim penal me 7 persona. Përderisa PTh e Prishtinës, 64 kallëzime me 81 persona; PTh e Prizrenit, 23 kallëzime me 34 persona; PTh e Pejës, 11 kallëzime me 17 persona; PTh e Gjilanit, 13 kallëzime me 19 persona; PTh e Mitrovicës, 15 kallëzime me 18 persona; PTh e Ferizajt, 10 kallëzime me 22 persona dhe PTh e Gjakovës, 17 kallëzime me 25 persona Te zgjidhura gjatë tremujorit të katërt janë gjithsej 82 kallëzime penale, me 155 persona.	Pjesërisht e plotësuar.
514	Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit	9. 10% më tepër e aktakuzave të ngritura për veprat penale të korrupsionit	K4 2017	KPK.	Të gjitha prokuroritë, gjatë kësaj periudhe kanë zgjidhur kallëzime penale për 155 persona, prej tyre ndaj 45 personave janë ngritur Aktakuza. Personat për të cilët janë zgjidhur rastet,	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					<p>sipas prokurorive janë si në vijim: Prokuroria Speciale gjate kesaj periudhe nuk kishte aktakuza të ngritura; PTh e Prishtinës, rastet për 91 persona prej tyre 20 Aktakuza; PTh e Prizrenit, rastet për 17 persona prej tyre 9 Aktakuza; PTh e Pejës, rastet për 6 persona prej tyre 3 me Aktakuzë; PTh e Gjilanit, rastet për 9 persona prej tyre 4 Aktakuza; PTh e Mitrovicës, rastet për 7 persona prej tyre 5 Aktakuza; PTh e Ferizajt, rastet për 5 persona prej tyre 1 Aktakuza; PTh e Gjakovës, rastet për 16 persona prej tyre 3 Aktakuza.</p> <p>Sqarim: Pasqyrimi i kallëzimeve të zgjidhura penale gjatë një periudhe, behet për persona, për shkak të vendimit të prokurorit për secilin person veç e veç në kuadër të një kallëzimi.</p>	
515	Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të krimit të organizuar	10. 10% më tepër të aseteve të sekuestruara të fituara përmes veprës penale	K4 2017	KPK.	Sekuestrim - 979,749.18 EUR, ndërsa Ngrirje - 1,746,609.82 EUR	Pjesërisht e plotësuar
516	Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të krimit të organizuar	11. 10% më tepër të aseteve të konfiskurara me vendim të formës së prerë	K4 2017	KPK.	Konfiskime 1,220,315.92 EUR (Patundshmeri, automjete, dhe paisje teknologjike)	Pjesërisht e plotësuar
517	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	12. Numri i aktgjykimeve te shkalles se pare dhe te dyte dhe te dhenat lidhur me aktgjykimet per vepra penale te krimit te organizuar, korrupsionit (liruese/denuese etj)	K4 2017	KGJK.	Gjatë vitit 2017 gjykatat e shkallës së parë kanë zgjidhur 5 lëndë, prej tyre: 3 lëndë – dënim me burg, 1 lëndë – dënim me gjobë dhe 1 lëndë – në mënyrë tjetër. Gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar 3 lëndë prej tyre, 2 lëndë janë ndryshuar dhe 1 lëndë është anuluar.	Pjesërisht e plotësuar
518	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e	13. Numri i kallximeve penale lidhur me rastet e trafikimit me qenie njerezore dhe kontrabandes me migrante	K4 2017	MPB.	Në periudhën raportuese K3 dhe K4 janë ngritur 43 kallëzime penale për veprat penale të TQNJ dhe veprave tjera penale	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

	luftimit të organizuar dhe korrupsionit				që ndërlidhen me TQNJ. Departamenti për Hetimin e Krimit të Organizuar për veprën penale kontrabandim me migrantë ka ngritur1 (nje) kallëzim penal.	
519	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	Numri i aktakuzave të ngritura për veprat penale të TQNJ dhe kontrabandes me migrantë	K4 2017	MPB. KPK	Nuk ka	E paplotësuar
520	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	15. Numri i informatave të shkëmbyera ne rastet e trafikimit me qenie njerëzore me institucionet vendore dhe ndërkombëtare	K4 2017	MPB.	Për periudhën raportuese K3 dhe K4 janë shkëmbyer 13 informata me vendet tjera përmes ILECU. Gjithashtu mbahen kontakte të vazhdueshme nga MPB me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në shkëmbim të informatave si me Qendrat e punës sociale, Inspektoratit Policor të Kosovës, inspektorët e punës dhe EULEX-in etj.	Pjesërisht e plotësuar
521	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	16. Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore te identifikuar nga PK	K4 2017	MPB.	Gjatë periudhës raportuese K3 dhe K4, DHTQNJ ka identifikuar 16 viktimat të Trafikimit.	Pjesërisht e plotësuar
522	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	17. Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të trajtuara në strehimore	K4 2017	MPMS.	Ka vazhduar strehimi dhe rehabilitimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në strehimoren shtetërore. Përgjatë periudhës kohore janë strehuar 23 raste të trafikimit. Nga ky numër 4 raste kanë qenë viktimat të huaja të trafikimit; 13 raste kanë qenë viktimat të mitura dhe 10 raste viktimat të rritura.	E plotësuar
523	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	18. Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të riatdhesuara në shtetet e origjinës	K4 2017	MPB.	Gjatë K3 dhe K4 janë riatdhesuar në vendin e origjinës 4 viktimat të TQNJ.	Pjesërisht e plotësuar
524	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të organizuar dhe korrupsionit	19. Numri aktgjyqimeve te shkalles se pare dhe te dyte lidhur me TQNJ dhe dhe kontrabandes me migrante si dhe te dhenat rreth aktgjyqimeve (denuese, liruese etj)	K4 2017	KGJK.	Trafikimi me njerëz: Gjatë vitit 2017 gjykatat e shkallës së parë kanë zgjidhur 25 lëndë; Gjykata e shkallës së dytë ka zgjidhur 12 lëndë prej tyre;	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					Kontrabandimi me migrantë: Gjatë vitit 2017 gjykatat e shkallës së parë kanë zgjidhur 36 lëndë; Gjatë vitit - 2017 gjykata e shkallës së dytë ka zgjidhur 14 lëndë prej tyre	
525	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të terrorizmit	1. Numri i kallximeve penale të terrorizmit	K4 2017	MPB.	Gjatë këtij gjashtëmuajori nga Drejtoria kundër Terrorizmit janë iniciuar gjithsej 44 kallzime penale, kundër 60 personave për vepra penale që ndërlidhen me terrorizmin	E plotësuar
526	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të terrorizmit	3. Numri i informacioneve të shkëmbyera me institucionet vendore dhe nderkombtare.	K4 2017	MPB.	Gjatë këtij gjashtëmuajori janë shkëmbyer gjithsej 83 informata në nivel ndërkombëtar dhe 60 me institucionet vendore	E plotësuar
527	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të terrorizmit	4. Numri i aktakuzave të ngritura për veprat penale të terrorizmit	K4 2017	KPK.	Prokuroritë, gjatë kësaj periudhe, kanë zgjidhur kallzime penale, për 3 persona, prej tyre: ndaj 3 personave është ngritur Aktakuzë pas procedurës hetimore. Sqarim: Pasqyrimi i kallzimeve të zgjidhura penale gjatë një periudhe, behet për persona, për shkak të vendimit të prokurorit për secilin person veç e veç në kuadër të një kallzimi. Rastet e ngelura si të pazgjidhura Në fund të Tremujorit IV-2017, kanë ngelur të pazgjidhura 65 kallzime penale me 159 persona.	Pjesërisht e plotësuar
528	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të terrorizmit	7. Numri i aktykimeve dhe të dhenat rreth tyre	K4 2017	KGJK.	Të trashguara 22 lëndë; Të pranuar 9 lëndë; Të përfunduara 14 lëndë, prej tyre: 11 lëndë dënim me burg, 1 lëndë dënim me gjobë dhe 2 lëndë me kusht, 17 lëndë të mbetura në fund të vitit të cilat janë bartur në vitin aktual 2018.	Pjesërisht e plotësuar
529	Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të terrorizmit	8. Fushata vetëdijësuese lidhur me parandalimin e terrorizmit	K4 2017	MPB.	Nga Drejtoritë Rajonale të Policisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policimit në Bashkësi janë organizuar gjithsej 4 takime, në model të trajnimeve për nxënës të ciklit të ulët dhe të mesëm të arsimit, lidhur me rrezikun që paraqet	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që shpie në terrorizëm	
530	Të intensifikohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar	1. Numri i rasteve të proceduara dhe të trajtuara në çështjet e ashkëpunimit juridik ndërkombëtar, përfshirë edhe Republikën e Serbisë	K4 2017	MD. MPJ	Gjate vitit 2017 janë ekstraduar gjithsej 44 persona, 2 transferime te personave te dënuar dhe jane proceduar 5196 kërkesa/përgjigje për ndihmë juridike ndërkombëtare	Pjesërisht e plotësuar
531	Të intensifikohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar	2. Numri i Marrëveshjeve të nënshkruara	K4 2017	MD. MPJ	Janë nënshkruar dy Marrëveshje ndërkombëtare me Hungarinë, respektivisht "Traktati për Ekstradim" dhe "Traktati për Transferimin e Personave të Dënuar"	Pjesërisht e plotësuar
532	Miratimi i kornizës së re strategjike dhe masave implementuese në fushën e kërkimit dhe inovacionit	4. Institutet Kërkimore Shkencore, të pajisur me pajisje laboratorike	K4 2017	MASHT.	Nuk është realizuar Për shkak të shkurtimeve buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, ky proces ka mbetur pa u realizuar.	E paplotësuar
533	Forcimi i kapaciteteve për rritjen e pjesëmarrjes në programin e BE Horizon 2020	1. Pikat kombëtare të Kontaktit për programin "Horizon 2020", të përkrahur për të përmirësuar koordinimin dhe ofrimin e informacionit për komunitetin shkencor/hulumtues	K4 2017	MASHT.	Nuk ka pasur progress	E paplotësuar
534	Forcimi i kapaciteteve për rritjen e pjesëmarrjes në programin e BE Horizon 2020	2. Sesione, aktiviteteve informuese dhe konferenca vjetore për Horizon 2020, të organizuara	K4 2017	MASHT.	Nuk ka pasur progress.	E paplotësuar
535	Forcimi i kapaciteteve për rritjen e pjesëmarrjes në programin e BE Horizon 2020	3.WEB - faqja për programin Horizon 2020, e krijuar	K4 2017	MASHT.	Nuk ka pasur progress	E paplotësuar
536	Përmisimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë	1. Sistemi i menaxhimit të informatave në Institucionet e Arsimit të Lartë (SMIAL), funksional	K4 2017	MASHT.	Është realizuar MASHT me ndihmën e donatorëve kanë themeluar dhe funksionalizuar sistemin SMIAL	E plotësuar
537	Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe	2. 4 shkolla të reja, të ndërtuara (4 klase parafillore 5-6 vjet)	K4 2017	MASHT. DKA	Pjesërisht i realizuar Kanë përfunduar 2 shkolla me 3 klasë për parafillor: Shkolla në Duhël –Suharekë me 2 klasë për parafillor dhe	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

	fëmijët me nevoja të veçanta				Shkolla në Batllavë – Podujevë me I klasë për parafillor	
538	Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	3. 9 kopshte, institucione parashkollore publike të ndërtuara	K4 2017	MASHT. DKA	Pjesërisht i realizuar, me vonesa Në kuadër të ndërtimit të shkollave fillore janë shtuar edhe 3 klasë parafillore. Me donacionet e EU-së dhe participimin e MASHT në projektin “IPA II 2016” janë planifikuar ndërtimi i 8 çerdheve.	Pjesërisht e plotësuar
539	Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	4. Kurrikula bërthamë për edukim parashkollor, e finalizuar dhe e pilotuar	K4 2017	MASHT.	Ende nuk është realizuar. Është përgatitur drafti i dokumentit.	E paplotësuar
540	Harmonizimi i programeve arsimore të AAP me nevojat e tregut të punës	2. Standardet e profesionit për të rritur, të hartuara	K4 2017	MASHT. MPMS	Është realizuar sipas planit. Deri me tani janë hartuar 50 standarde të profesionit. 24 profile janë kompletuar me kurrikulë të rishikuar, materiale mesimore, pajisje për punëtorit.	E plotësuar
541	Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	5. Ekipet vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara në komuna, të trajnuar	K4 2017	MASHT. Komunat	I realizuar. 70 anetar të ekipeve vlerësuese nga 8 komuna janë trajnuar për vlerësimin e nxënësve me sindromin doën, autizëm, dëmtimet në degjim dhe dëmtimet në të pamuar. Jane trajnuar ekipet vlerësuese të 10 komunave dhe ne bashkepunim me ta janë hartuar instrumentet për shkolla dhe ekipet vlerësuese pedagogjike në komuna bazuar në ICF (International Classification Functioning Children & Youth). Instrumentet janë hartuar dhe nga muaji mars 2018 do të pilotohen në 8 komuna dhe 16 institucione arsimore. Gjatë kësaj periudhe do të behet monitorimin i instrumenteve nga Ekspert nga Universiteti i Bolonjës dhe Padovës në Itali. Janë pajisur dhomat e punës së ekipit vlerësues me materiale, pajisje dhe kënde	E plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në 7 komuna. Në bashkëpunim me Forumin Kosovar i Aftësisë së Kufizuar dhe UNICEF janë organizuar tryeza të rrumbullakëta në 5 komuna ku ekipet vlerësuese nuk janë funksionale. Qëllimi i tryezave ishte diskutimi i rolit dhe rëndësisë së funksionit të ekipeve vlerësuese në komuna.	
542	Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	6. 25 asistentë të nivelit të pestë (SNKA), për fëmijët me nevoja të veçanta të pranuar nga Qendra e Kompetencës në Ferizaj; si dhe standardet e profesionit dhe kurrikulat e hartuara	K4 2017	MASHT.	Eshte realizuar sipas planit. Kurrikulat janë hartuar nga Instituti "PEARSON " Angli, është mbajtur trajnimi për trajnerë në Qendren e Kompetencës në Ferizaj nga ekspert të Insitutit PEARSON dhe jane certifikuar 17 trajnerë	E plotësuar
543	Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e ujërave nga veprimet e dëMShme	I. Hulumtimi gjeofizik i trupave ujqor nëntokësor në Pellgun e Drinit të Bardhë, i përfunduar	K4 2017	MMPH. MSh Komunat UP MBPZhr	Është kryer faza e studimeve gjeofizike të trupave ujqorë nëntokësorë në pellgun lumor Drini i Bardhë dhe dorëzimi I draft Raporteve të K6 për Hulumtimin gjeofizik i hulumtimin të burimeve ujqore nëntokësore në pellgun e lumit Drini i Bardhë: Lot A- studimi gjeofizik i ujqorë nëntokësorë, Lot B-Karakterizimi i trupave ujqorë nëntokësorë dhe Lot C- përshkrimi i Aglomerimeve në pellgun e lumit Drini i Bardhë .	E plotësuar
544	Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e ujërave nga veprimet e dëMShme	I. Plani i menaxhimit për Pellgun e Drinit të Bardhë - Faza fillestare për identifikimin i çeshtjeve të ndjeshme (erozionet, vershimet, pikat e ndotjes), e përfunduar		MMPH. ZKM MZhe MIE MF Komunat MSh Operoret	Sipas projektit, faza fillestare për identifikimin i çeshtjeve të ndjeshme ka përfunduar. Është përgatitur programi i punës dhe kalendari i aktiviteteve për përgatitjen e "Planit të Menaxhimit të Pellgut Lumor Drini i Bardhë" i cili është publikuar në web të qeverisë për komente eventuale.Është hartuar draft Raporti i mangësive te te dhenave dhe	E plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					disponueshmeria, i cili është shperndare për komente dhe sygjerime.	
545	Përmirësimi i politikave për menaxhimin e parqeve kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharr"	I. Numri i zonave të identifikuara për përgatitjen e planeve rregulluese	K4 2017	MMPH. MBPZhr Komunat që shtrihen në zonën e Parqeve	Hartimi i katër Planeve rregulluese të hollësishme për zonat e treta të Parqeve Kombëtare (nga dy në Parqet Kombëtare "Sharr" dhe "Bjeshkët e Nemuna"), është duke u bërë në kuadër të Projektit "Programi Mjedisor për Kosovën" përkrahur nga SIDA. Zbatimi i projektit ka filluar, dhe gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë këto aktivitete: Është bërë përzgjedhja preliminare e 4 lokacioneve. Fjala është për lokacionin në Boge (Komuna e Pejës) dhe lokacioni i dytë i ashtuquajtur "Gropa e Erenikut" (Komuna e Junikut) në PK "Bjeshkët e Nemuna". Ndërsa, në PK "Sharri" është përzgjedhë lokacioni në Prevallë dhe në Fshatin Restelicë.	E plotesuar
546	Zbatimi i Strategjisë dhe politikave për produktet pyjore jodrusore	I. Inventarizimi nacional dhe përcaktimi i kuotave vjetore për produktet pyjore jo-drusore	K4 2017	MBPZhr. MMPH MAPL Komunat APP	Dokumenti është hartuar	E plotesuar
547	Përmirësimi i politikave për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura	I. Programi nacional për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura 2016-2025, i miratuar		MBPZhr. MMPH MAPL Komunat APP	Ende nuk është miratuar.	E paploesuar
548	Integrimi i zvogëlimit të rrezikut në politika dhe plane zhvillimore	I. Hartimi i Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME-ve) sipas Planit të Reagimit Kombëtar- FME#1-Transporti FME#3- Komunikimi dhe FME#8 Mjekësia, të përfunduara	K4 2017	AME. MI MPB MBPZHR		
549	Ngritja e kapaciteteve institucionale për zbatim të legjislacionit në fushën e mjedisit	I. Tri trajnime për zbatimin e legjislacionit mjedisore në kuadër të "Programit mjedisor të Kosovës", të realizuara	K4 2017	MMPH. Komunat	Jane realizuar te gjitha trajnimet e parapara.	E plotesuar
550	Ngritja e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e sistemit të monitorimit	I. Trajnimi për matjen e emisioneve nga burimet e palëvizshme të ndotjes, i realizuar	K4 2017	MMPH. KEK MZHE	Eshte duke shkuar sipas planifikimeve me kete nenkuptojme se kjo objective eshte ne realizim e siper.	Pjeserisht e plotesuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

	(kontrollit) të ndotjës së ajrit					
551	Ngritja e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e sistemit të monitorimit (kontrollit) të ndotjës së ajrit	I. Trajnimi për kalibrimin e analizereve të monitorimit të cilësisë së ajrit, i realizuar	K4 2017	MMPH. KEK MZHE	Ka vonesa për realizimin e kesaj objective.	E paplotesuar
552	Ngritja e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e sistemit të monitorimit (kontrollit) të ndotjës së ajrit	I. Trajnimi për zhvillimin e Inventarit të emisioneve në ajër, i realizuar	K4 2017	MMPH. KEK MZHE	Trajnimet për Inventarin e emisioneve në ajër janë mbajtur nga data 1 deri me 13 dhjetor dhe kanë marrë pjesë 6 zyrtarë nga AMMK, 2 zyrtarë nga DMMU si dhe nga një përfaqësues nga Komuna e Prishtinës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencioni i Emergjencave	E plotesuar
553	Ngritja e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e sistemit të monitorimit (kontrollit) të ndotjës së ajrit	I. Trajnimi për modelim/simulim, i realizuar	K4 2017	MMPH. KEK MZHE	Trajnimet për modelimin dhe simulimin e ndotjes së ajrit për regjionin e Prishtinës janë mbajtur nga data 7 deri me 13 dhjetor dhe kanë marrë pjesë 5 zyrtarë nga MMPH/AMMK dhe një zyrtarë nga MZHE. - E perfunduar.	E plotesuar
554	Ngritja e kapaciteteve institucionale në sektorin e ujërave	I. Trajnimi mbi përmirësimin e bashkëpunimit të nivelit qendror dhe lokal për zbatimin e legjislacionit uhor sipas Direktivës Kornizë të Ujit, i realizuar	K4 2017	MMPH. Komunitat MSh MBPZHR	Eshte perfunduar kjo objective sipas planifikimeve	E plotesuar
555	Ngritja e vetëdijes qytetare për legjislacionin mjedisor	I. Fushatat dhe debatet publike me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit, të realizuara	K4 2017	MMPH. Komunitat	Eshte perfunduar kjo objective sipas planifikimeve	E plotesuar
556	Përmirësim i sistemit të monitorimit (kontrollit) të ndotjës së ajrit dhe instalimi i softwerit	I. Numri i stacioneve të ajrit, të mirëmbajtura	K4 2017	MMPH. MAP	Jane mirembajta 11 stacione, 10 stacione fikse dhe nje (1) stacion mobil.Treguesit (parametrat) e cilësisë së ajrit të raportuar permes raportit vjetor janë: NOx, SO2, CO, O3, PM10 dhe PM2.5.	E plotesuar
557	Përmirësim i sistemit të monitorimit (kontrollit)	I. Softweri qendror për raportimin e të dhënave që publikohen, i instaluar	K4 2017	MMPH. MAP	Blerja dhe instalimi i softweri qendrore është në procedurë të prokurimit.-	E paplotesuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

	të ndotjës së ajrit dhe instalimi i softwerit					
558	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë	I. Pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e Azbestit, i realizuar	K4 2017	MMPH. Komuna e Hanit të Elezit	Lumi Lepenc është pastruar nga mbeturinat e azbestit përgjate brigjeve në gjatësi prej 1.1 km në zonën urbane të Hanit të Elezit. Sipas Projektit është pastruar edhe pjesa e fushës së sportit.	E plotësuar
559	Zbatimi i Master Planit për menaxhimin e mbeturinave komunale	I. Gara për mjedis të pastër (17 komuna) dhe përzgjedhja e komunave fituese, përfunduar	K4 2017	MMPH. MAPL Komunat	Kjo objektive ka përfunduar	E plotësuar
560	Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare	I. Rrethimi fizik i zonës së parë të Burimit Ujor të shpallur i mbrojtur me Vendim	K4 2017	MMPH. ZKM MSh Komunat KRU	Nga të gjitha burimet e parapara edhe 19 të tjera mbesin në pritje për shpallje.	Pjesërisht e plotësuar
561	Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare	I. Numri i komunave të cilat i kanë përfshirë zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planet Rregulluese detajore	K4 2017	MMPH. ZKM MSh Komunat KRU MAPL	15 komuna i kanë përfshirë zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planet Rregulluese të hollësishme.	Pjesërisht e plotësuar
562	Zbatimi i tarifave për kompenzimin e shfrytëzimit të ujërave, shkarkimin e ujërave, inerteve dhe koncesioneve	I. Numri i operatorve të shfrytëzuesve të ujit që përmbushin obligimet sipas tarifave të reja	K4 2017	MMPH. ZKM MF Operatorët	Trembëdhjetë (13) operator ekonomik që shfrytëzojnë ujin kanë përmbushë obligimet sipas legjislacionit primar dhe sekondar për tarifa. Aktivitetet që vazhdon të realizohet.	Pjesërisht e plotësuar
563	Zbatimi i tarifave për kompenzimin e shfrytëzimit të ujërave, shkarkimin e ujërave, inerteve dhe koncesioneve	I. Numri i shlyerjeve të borxheve të trashëguara nga shfrytëzuesit e ujit	K4 2017	MMPH. ZKM MF Operatorët	Trembëdhjetë (13) operator ekonomik që shfrytëzojnë ujin kanë përmbushë obligimet sipas legjislacionit primar dhe sekondar për tarifa. Aktivitetet që vazhdon të realizohet.	Pjesërisht e plotësuar
564	Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza	I. Shpronësimi, shpallja e tenderit, tenderimi, projekt dizajni i projektit për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Pejë, e përfunduar	K4 2017	MMPH. ZKM MF Operatorët	Kuvendi Komunal i Komunes së Pejës ka siguruar lokacionin për ndërtimin e Impiantit në fshatin Glaviçice.	E plotësuar
565	Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza	I. Lokacioni i projektit për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Pejë, i përcaktuar	K4 2017	MMPH. MZHE MF Komuna		E plotësuar
566	Përgatitja e Listës së Kuqe të llojeve të faunës	I. Numri i llojeve të faunës të përfshira në Listën e Kuqe	K4 2017	MMPH. MBPZHR UP Komunat	Numri i llojeve të faunës caktohet pas përgatitjes së Librit të kuq të Faunës.	E paplotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

567	Përgatitja e Listës së Kuqe të llojeve të faunës	I. Numri i Kategorive të faunës të përfshira sipas rrezikshmërisë	K4 2017	MMPH. MBPZhr UP Komunat	Kjo objective eshte përfunduar sipas planifikimit.	E plotesuar
568	Edukimi mjedisor dhe vetedijësimi për mbrotjen e natyrës (Kopshti Botanik)	I. Lokacioni i Kopshti Botanik, i përcaktuar	K4 2017	MMPH. MASH T MBPZhr UP Komuna e Prishtinës	Kopshti Botanik i Prishtinës ashtu siq është raportuar në K3 ka deshtuar dhe Projekti është planifikuar që në 2018 të realizohet me Komunen e Mitrovicës.-	E paplotesuar
569	Mbrojtja e vlerave natyrore	I. 19 rezervate strikte të natyrës, të shenjëzuara	K4 2017	MMPH. Organet menaxhuese të zonave të mbrojtura	Janë përgatitur specifukacionet për shënjëzimin e 19 rezervateve strite të natyrës .Në rishikimin e buxhetit Ministria e Financave i ka tërhequr mjetet për shënjëzimin e rezervateve strikte dhe per kete aresye aktiviteti eshte nderprere.	E paplotesuar
570	Inspektimi në funksion të zbatimit të legjislacionit mjedisor	I.Numri i inspektimeve, të realizuara	K4 2017	MMPH. PK Komunat Gjykatat	KI 2017 - K4 2017: - Në fushën e Mjedisit dhe Ujërave, sipas Planit të Punë gjatë periudhës kohore 1 janar 2017 - 31 Dhjetor 2017 janë zhvilluar aktivitete të cilat kanë rezultuar si vijon: - Janë zhvilluar 806 vizita inspektuese - Janë lëshuar 5 Vendime - Janë bërë 152 inicime - Janë dhënë 669 rekomandime, urdhëresa, vërejtje. Gjithashtu Inspektorat gjat] periudhes janar -dhjetor 2017 ka realuizuar: -1036 inspektime me procesverbal; -23 vendime; -156 inicime në Gjykatë; -776 rekomandime, vërejtje etj; -39 inspektime të përbashkëta me KFOR-in, FSK-në, etj. rreth menaxhimit dhe mbikëqyrjes së materialeve të rrezikshme.	E plotesuar
571	Mbikqyrja e të gjitha aktiviteteve të ndaluara në Zonat e Veçanta të Mbrojtura	I.Numri i ndalimeve për ndërhyrjet/aktivitetet e ndaluara (ndërtime fizike, degradime etj) në Zonat Veçanta të Mbrojtura, të ndërmar	K4 2017	MMPH. Komunat	Kjo objektive ka përfunduar	E plotesuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

572	Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së shëndetit publik	Anetarësimi i Kosovës në Rrjetin Shëndetësor të Evropës Juglindore	K4 2017	MSh. MPJ	Ministria e Shëndetësisë ka inicuar këtë process nga viti 2014 në MPJ por deri me sot nuk kemi marrë konfirmim për paraqitjen e kërkesës. Kjo është përgjegjësi e MPJ.	E paplotesuar
573	Ngritja e kapaciteteve administrative për qendrat e transfuzionit të gjakut	Koordinatori Nacional për Transplantim, i emëruar	K4 2017	MSh. ZKM	Ministria e Shëndetësisë e ka inkuorporuar strukturën e Divizionit të Biomedikimit ku hyn edhe koordinatori nacional. Presim procedimin e rregullores në MAP. Me miratimin e rregullores së brendshme mundësohet emërimi i koordinatorit nacional. Ndërsa sa i përket kapaciteteve administrative në Qendrat e transfuzionit kjo pjesë është pjesë e projektligjit të gjakut dhe produkteve të tij që është miratuar në Qeveri me datë 20 Dhjetor 2017.	E paplotesuar
574	Përmirësimi i cilësisë në ofrimin e shërbimeve dhe ngritja e vetëdijes tek konsumatorët.	I. Ngritja e vetëdijes së konsumatorëve përmes: spoteve, broshurave dhe mjeteve tjera informative, të realizuara	K4 2017	MTI.	K1: 1. Organizimi i tryezës së rrumbullakët me temën: Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit. 2. Shpërndarja e materialit promovues në sheshin Nena Terezë dhe katër qendrat e tjera kryesore të Kosovës. 3. Krijimi dhe Shtypja e 10000 flajerit vetëdijësues në lidhje me vetëdijimin e konsumatorit për ueb-faqen e re (mënyra se si të ankojnë) për mbrojtjen e konsumatorit. K2: Në bashkëpunim me divizionin për të drejtat e njeriut mbajtja e ligjëratës me nxënësit e shkollës fillore Stefan Gjeqovi në Janjevë. K3: 1. Hartimi dhe shtypja e rreth 500 flajerave me informata të përgjithshme për mbrojtjen e konsumatorit në gjuhën serbo-kroate. 2. Ndryshimi i dizajnit dhe shtypja e 3000 flajerave me informata të përgjithshme për mbrojtjen e konsumatorit. 3. Është arritur, përgatitur dhe përcjellë marrëveshja me operatorin	E plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					Vala për shpërndarjen e mesazheve të të gjithë konsumatorëve të Kosovës në lidhje me të drejtën e konsumatorit. K4: Në bazë të marrëveshjes së arritur me operatorin Vala është realizuar shpërndarja e mesazheve të të gjithë konsumatorëve të Kosovës në lidhje me të drejtën e konsumatorit.	
575	Pranimi dhe shqyrtimi efektiv i ankesave të pranuar nga konsumatorët.	2. Numri i ankesave të pranuar, të zgjedhura dhe të pashqyrtuara	K4 2017	MTI.	K1: Gjatë kësaj periudhe raportuese ishin gjithsej 56 ankesa të pranuar, prej tyre 20 janë shqyrtuar, 17 janë zgjidhur në favor të konsumatorit dhe 19 janë refuzuar si të pa bazuara. K2: Gjithsej janë pranuar 29 ankesa, 7 të zgjidhura dhe 22 në proces të shqyrtimit. K3: Gjithsej janë pranuar 50 ankesa, prej tyre 19 janë zgjidhur në favor të klienteve, 20 janë refuzuar si të pabazuara dhe 11 janë në shqyrtim. K4: Gjatë tremujorit të fundit 2017, janë pranuar gjithsej 70 ankesa, prej tyre 11 janë zgjidhur në favor të klienteve; 11 janë refuzuar si të pabazuara dhe 48 nuk janë shqyrtuar apo janë ende në shqyrtim	E plotësuar
576	Pranimi dhe shqyrtimi efektiv i ankesave të pranuar nga konsumatorët në lidhje me Shërbimet Financiare	1. Numri i ankesave të pranuar dhe shqyrtuara në lidhje me Shërbimet Financiare	K4 2017	BQK.	Nga të dhënat e ankesave, vërejmë rritje të numrit të ankesave ndër vite. Krahasuar me vitin 2016, gjatë vitit 2017 ka rritje prej 13% të numrit të ankesave të trajtuara. Gjatë vitit 2016, 44% e total ankesave janë zgjidhur në favor të palëve, ndërsa gjatë vitit 2017, 35% e ankesave janë zgjidhur në favor të palëve. Gjatë vitit 2016, 56% e total ankesave janë refuzuar, ndërsa gjatë vitit 2017 përqindja e ankesave të refuzuara është 60% e ankesave.	E plotësuar Ne realizim e sipër
577	Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues	1. Tre Udhërrëfyes në lëmin e shëndetit seksual dhe riprodhues të miratua	K4 2017	MSh. Komunitat	Sa i përket hartimit të standardeve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore janë	Pjesërisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					aprovuar dy (2) udhërrëfyes klinik nga lëmi e shëndetit riprodhues.	
578	Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues	2. Numri i trajnimeve për shëndet të nënës si dhe përmirësimin e cilësisë, së fëmijës dhe shëndet riprodhues	K4 2017	MSh. Komunat	Sa i përket burimeve njerëzore gjatë vitit 2017 janë trajnuar 269 profesionist shëndetësor në fushe e shëndetit të nënës dhe fëmijës.	Pjeserisht e plotësuar
579	Përmirësimi i sistemit aktual elektronik INES	1. Sistemi aktual elektronik INES për regjistrimin dhe aplikimin online për mbrojtje të DPI me sistemin COPIS, i funksionalizuar dhe harmonizuar	K4 2017	MF. DK	Në sistemin INES janë duke u futur të dhënat për vitin 2017, ku deri më tani kemi plotësuar me 207 raste dhe 29 aplikacione veprim doganor duke i përfshirë 109 marka tregtare. Sektori në këtë fazë të implementimit ende nuk mund të gjeneroj raporte nga sistemi elektronik INES. Raportet gjenerohen nga data baza EXL që menaxhohet nga sektori i DPI-së. Për mbarëvajtjen dhe implementimin me sukses të sistemit elektronik INES është e nevojshme asistencë teknike nga ekspertët e vendeve të BE-së që përdorin këtë sistem.	Pjeserisht e plotësuar
560	Vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale	1. Numri i operacioneve të përbashkëta të Doganës me instucionet tjera vendore si PK , Prokuroria, dhe akter tjere te zbatimit te ligjit, i rritur	K4 2017	MF. DK	Gjatë vitit 2017, DK në bashkëpunim me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit ka realizuar 110 operacione-asistencë të përbashkëta	Pjeserisht e plotësuar
561	Vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale	2. Numri i shkembimeve te informatave me vendet e BE-se, i rritur	K4 2017	MF. DK	Gjatë vitit 2017, në fushën e Bashkëpunimit Ndërkombëtar janë shkëmbyer në total 159 korrespondenca, kryesisht me vendet e rajonit por edhe me vendet e BE-së dhe më gjerë.	Pjeserisht e plotësuar
562	Vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale	3. Numri i rasteve të zbuluara, i rritur	K4 2017	MF. DK	Gjatë periudhës raportuese Janar-dhjetor 2017: - janë zbuluar 90 raste të mallrave të ndaluara (Janar-Dhjetor 2017), 33 raste me armë dhe municion, dhe 57 raste me narkotikë (gjithsej 175,981.09 gram). - Janë ndërmarrë aktivitete për luftimin e dukurisë së përpunimit dhe vendosjes në treg të duhanit ilegal – që si	E plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

					<p>fushë është goditur edhe gjatë vitit 2017. Në 5 operacione të ndryshme, janë sekuestruar afër 10 ton të këtij produkti dhe 4 makineri të shfrytëzuara për përpunim;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë regjistruar gjithsej 50 raste të reja nga sektori i Hetimeve ; - Janë dorëzuar në Prokurori 55 kallëzime penale ku numri i personave të kallëzuar është 82 dhe se shmangiet e konstatuara janë në lartësi prej 2,492,589.19 € - Janë ekzekutuar 7 mandate të Gjykatës për bastisje dhe me këtë rast janë bastisur rreth 25 lokacione të ndryshme. Mallrat e sekuestruara gjatë kësaj periudhe kapin shifrën prej 470.449.54 € - Gjatë këtij viti janë iniciuar 1617 kundërvajtje doganore 	
563	Ngritja e performancës së Doganes në ofrimin e procedurave më efektive doganore	I. Koha për fazën e zhdoganimit përmes shfrytëzimit të kanalit të gjelbert, e reduktuar	K4 2017	MF. DK	<p>Në muajin Mars 2017, Banka Botërore, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, ka zhvilluar një studim për matjen e kohës së zhdoganimit të mallrave nga momenti i hyrjes e deri në përfundim të procedurave doganore në eksport dhe në import. Gjetjet kryesore të këtij projekti japin rezultat pozitiv dhe vlerësohet përsheptimi i procedurave zhdoganimit dhe lehtësimi i tregtisë.</p> <p>Në kanalin e gjelbër kanë kaluar 85 % e deklaratave të përgjithshme të Eksportit dhe 10% e deklaratave të importit.</p> <p>70% e deklaratave të përgjithshme në IM/EX kanë përfunduar procedurën e zhdoganimit brenda intervalit 05-60 min.</p>	Pjeserisht e plotësuar

PËRFORMANCA E INSTITUCIONEVE NË GJASHTË MUJORIN I DYTË, PËR VITIN 2017.

564	Ngritja profesionale në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit	1. Pilot projektet për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në 5 organizata buxhetore, të përfunduara	K4 2017	NjQH. MFK IKAP OB	<p>5 Pilotet për menaxhim financiar dhe kontroll janë përfunduar si rezultat i kësaj është përgatit “Libri i përshkrimi i proceseve – gjurmët e auditimit”, është aprovuar nga ministri i financave dhe është publikuar ne ueb faqe Ministrisë së financave dhe u është dërguar gjitha OB në mënyrë elektronike te cilat mund te përdorin si një model te mire secili për organizatën e tyre .</p> <p>Në bashkëpunim me USAID këto pilote aktualisht janë duke u zhvilluar edhe 5 komuna tjera.</p> <p>Është finalizuar pyetësori për vete vlerësim ne sistemin online për vitin 2017, tani te gjitha OB janë duke punuar ne plotësimin e tyre.</p>	E plotësuar
565	Ngritja profesionale në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit	2. Trajtime për llogaridhënie të menaxherëve të lartë, për azhurnimin e regjistrave të rreziqeve dhe trajtime të performancës, të mbajtura	K4 2017	NjQH. MFK IKAP OB	<p>Janë mbajtur trajnim me zyrtar nga të gjitha OB për, plotësimin e Pyetësorit vete vlerësues, identifikimi analiza dhe menaxhim te rrezikut i cili u realizua në bashkëpunim me IKAP.</p> <p>- Në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut është zhvilluar trajnimi me temat “Rreziku, Kontrolli, auditimi i brendshëm dhe kultura e rrezikut”.</p> <p>- Seminari për temën “Menaxhimi i rrezikut, përshkrimi i proceseve dhe Pyetësori vete vlerësues për te gjitha OB”. Pjesëmarrës ishin Drejtorët për buxhet, zyrtarët kryesor financiar, kryesuesi i komiteteve dhe drejtorët e NjAB, (Trajnimi është organizuar në bashkëpunim me USAID-in).</p>	E plotësuar
566	Trajnimi i auditorëve të brendshëm në Programin	1. Trajnimi i AB në programin për çertifikim, raportim, sigurim të cilësisë,	K4 2017	NjQH. AB IKAP MASHT OB	- Trajnimi i grupit të dytët të auditorëve të brendshëm në programin për	E plotësuar

	kombëtar për trajnim dhe certifikim vendor dhe në Programin për arsimim të vazhduar profesional	dhe në programin për planifikim strategjik dhe vjetor, të mbajtura			<p>çertifikim është mbajtur gjatë muajit maj – qershor 2017. Në trajnim kanë marrë pjesë 39 pjesëmarrës. Trajnimi është organizuar në bashkëpunim me IKAPI-n dhe ka zgjat 25 ditë. Përveç trajnimit janë organizuar provimet dhe riprovimet. Gjatë vitit 2017 me sukses programin e certifikimit e kanë përfunduar 84 kandidatë të cilët janë pajisur edhe me certifikata.</p> <p>- Trajnimi me temën Raportimi është mbajtur gjatë muajit shkurt 2017. Trajnimi është organizuar në bashkëpunim me IKAPI-n dhe janë përfshirë 72 drejtor të njësive të auditimit të brendshëm.</p> <p>- Në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut është organizuar trajnimi për 32 auditor të brendshëm me temën “Fuqizimi i ekipeve të auditimit” pjesë e së cilës ishte edhe sigurimi i cilësisë. Trajnimi është organizuar gjatë muajit maj 2017.</p> <p>- Në bashkëpunim me KFOS, ZKA dhe NjQH është organizuar një punishte me drejtorët e NjAB të gjitha komunave. Temat e trajtuara ishin kualiteti i raporteve të auditimit dhe implementimi i rekomandimeve. Punishtja është organizuar gjatë muajit shkurt 2017.</p>	
567	Avansimi i teknologjisë informative për të zhvilluar cilësinë institucionale	I. Softueri për një auditim më efektiv, i instaluar dhe funksional	K4 2017	ZKA.	<p>Për shkak të kostos së lartë financiare, implementimi i Sofwerit të auditimit nuk ka mundur të realizohet.</p>	E paplotesuar

